



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.05/2016

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari Individual Faton Ademi, ne çështjen juridike te paditëses:

nga Mitrovica, te cilën me autorizim e përfaqëson Av. nga Prishtina, kundër te paditurës:

, te cilën e përfaqëson për shkak te borxhit ne emër te kompensimit te te ardhurave personale te mbi normës se përcaktuar, pas mbajtjes se seancës kryesore publike, me dt. 19.01.2018, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** kërkesëpadia e paditëses , ashtu që:
- II. **OBLIGOHET** e paditura c t'ia paguajë paditëses nga Mitrovica ne emër te kompensimit për 4 ore shtese për periudhën prej 01.09.2015 e deri 16.11.2015 si dhe kompensimit për 1 ore shtese për periudhën prej 11.11.2015 deri 31.08.2016, shumën totale prej 460.85 euro, të gjitha këto me kamat ligjore prej 8%, te gjitha ne afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit te aktgjykimit, nen kërcënimin e përmbartimit ligjor.
- III. **OBLIGOHET** e paditura qe ne emër te shpenzimeve procedurale paditëses t'ia paguajnë shumën prej 489.00 Euro, dhe atë ne emër te taksës për padi shume prej 15.00, ne, ne emër te përpilimit te padisë shume prej 104.00 euro, ne emër te ekspertizës financiare shumën prej 100.00 euro ne emër te dy përfaqësimeve shume prej 270.00 euro, qe të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nen kërcënim të përmbartimit ligjor.
- IV. **REFUZOHET** si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë se paditëses, përtej asaj të aprovuar.

Arsyetim

Paditësja me datën 06.01.2016 ka ushtruar padi për kompensim të të ardhurave personale të mbi normës së përcaktuar.

Gjykata, me dt. 11.10.2017, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i paditëses, dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuar i paditëses në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, nga administrimi i provave u vërtetua besueshmëria e kërkesëpadisë, andaj i propozon gjykatës që ta aprovon kërkesëpadinë si të bazuar duke e detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguaj shumë prej 512.05 euro me kamat ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i të paditurës në fjalën përfundimtare deklaroi: se mbetem në tërësi pranë thënieve gjatë seancës paraprake ku e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, pjesërisht e kundërshton ekspertizën konkretisht për muajin korrik dhe gusht si muaj të pushimit, dhe konsideron që qeshtja e kontributeve pensionale dhe tatimit nuk është dashur të përfshihen meqenëse ajo qeshtje mbetet obligim i palës së paditur dhe palës paditëse, andaj gjykatës ia le të vendos në baze të rezultateve të provave. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Gjykata, në procedurën e leximit të provave, referuar nenit 7 dhe 8, lexoi: ekspertizën financiare të dt. 05.10.2017; përgjigja e të paditurës dt. 10.12.2015; vërtetimi dt. 03.11.2015; kontrata e punës e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës 03.09.2015.

Nuk është kontestues fakti që paditësja është në marrëdhënie pune me të paditurën, respektivisht SHFMU " " ne Mitrovicë në cilësinë e arsimtarës të lëndës së matematikës me 20 ore të mësimi dhe me një pagë mujore prej 522.05 euro, që vërtetohet nga kontrata e punës e dt. 03.09.2015. Gjithashtu nuk është kontestuese se paditësja i ka mbajtur 24 ore mësimi që nga data 01.09.2015 e deri me datë 16.11.2015. Ndërsa nga data 17.11.2015 e deri me datë 31.08.2016 i mban 21 ore mësimi. Kjo vërtetohet nga vërtetimi i dt. 03.11.2015, që gjendet në shkresat e lëndës. Gjithashtu nuk është kontestues se paditësja ka paraqitur ankese në cili i ka rekomanduar DKA Mitrovicë që të vepron sipas Kontratës Kolektive të Punës të Arsimit Parauniversitar neni 11 të normës së punës të paragrafit 1 dhe

paragrafit të 7në afat prej 15 ditëve. Kjo vërtetohet nga përgjigja e dt. 10.12.2015.

Gjykata, lidhur me bazën e kërkesëpadisë, iu referua nenit 4 të Urdhëresës Administrative nr.17/2015 dhe dispozitës së nenit 7, si dhe nenit 11.1 dhe 11.7 të kontratës kolektive të SBASHK-ut.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, u refera në mendimet dhe konstatimet e ekspertit financiar, meqrastë u konstatua se kompenzimi për 4 orë shtesë të periudhës prej 01.09.2015 e deri 16.11.2015 si dhe kompenzimi për 1 orë shtesë për periudhën prej 17.11.2015 e deri 31.08.2016 është në shumë 460.85 euro (duke mos përfshirë muajt Korrik dhe Gusht. Ndërsa përlllogaritja e kamatave në bazë të kesaj ekspertize është në shumë prej 66.77 euro.

Gjykata pjesën tjetër të padisë dhe kërkesëpadisë e refuzoi si të pabazuar për arsye se muajt Korrik dhe Gusht, janë muaj pushimi, dhe nuk ka baze për kompenzim për këtë periudhë, pasi që realizohet përmes pagës së rregullt, dhe aprovoi për kompenzim shumën prej 460.85 euro, si dhe kamatën në shumë prej 66.77 euro. Ndërsa sa i përket kontributeve pensionale në barrë të punëdhënësit, kontributet pensionale në barrë të të punësuarit dhe tatimit në të ardhurat personale të llogaritura me këtë ekspertize, gjykata nuk i aprovon me arsyetimin se konsideron se kjo çështje mbetet obligim ligjor i palës së paditur dhe palës paditëse.

Gjykata, kostatimeve të ekspertit si me lartë, ia fali besimin e plotë si prove relevante, mbi bazën e të cilës edhe caktoi shumën e kompensimit në emër të kompensimit të të ardhurave personale të mbi normës së përcaktuar.

Gjykata, lidhur me përlllogaritjen e kamatës, u bazua në nenin 382 par 2 të LMD-se.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Prandaj, gjykata bazuar në të lartëcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.05/2016 data 19.01.2018

GJYQTARI

Faton Ademi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.